



CHAMBER OF COMMERCE & INDUSTRY
VLORE REGION

Vlore, 28 Prill 2013

DEKLARATE PER SHTYP

Ftese per shfaqje interesi per pjesemarrje ne aktivitetet nderkufitare te Dhomes se Tregtise dhe Industrise, Qarkut Vlore

Dhoma e Tregtise dhe Industrise, Qarkut Vlore, ne kuadrin e implementimit te projektit te programit IPA "Greqi-Shqiperi 2007-2013" implemeton projektin "IntActPlan: Plan Veprime te integruara per te rritur veprimtarine e SME ne zonat kufitare dhe per te krijuar mundesi per te depertuar ne tregjet e reja".

Dhoma e Tregtise Vlore, duke vleresuar implementimin e aktiviteteve per realizimin e ketij projekti ne bashkepunim me Dhomen e Tregtise se Thesprotise (Greqi, partneri Leader) dhe Shoqaten e Inovacionit BIC of Epirus (Greqi, partnere ne project), njofton anetaret e saj, se ne kuadrin e perpjekjeve per zhvillimin dhe promovimin e bashkepunimit nderkufitar per bizneset e Qarkut Vlore, ne deget: Prodhime Bujqesore, Frutikultura dhe Kultivimi i peshkut dhe prodhimet e detit, do te vazhdoje implementimin e projektit me aktivitetet e meposhtme:

- **Mision Biznesi (3 ditore) ne Moske (Rusi), ne 17 Qershor 2013**, gjate ketij misioni do te realizohen takime B2B (biznes me biznes), per te dy sektoret e interesuar.
- **Nje pjesemarrje ne Panairin nderkombetar "Alimenta 2013" ne Bukuresht (Rumani)**, ne 30 Tetor 2013 deri me 03 Nentor 2013, me prezantim ne nje stende (prodhime bujqesore-fruta).
- **Nje pjesemarrje ne Panairin nderkombetar "Fresh Produce Ukraine 2013" ne Kieve (Ukrahine)**, prej dates 26 deri me 28 Nentor 2013, me prezatim ne stende (prodhime bujqesore-fruta).

Ftojme te gjitha bizneset e sektoreve te frutikultures, prodhimeve bujqesore, peshkimit, qe jane te interesuara te marrin pjese ne aktivitetet e siperpermendura te kontaktojne prane Dhomes se Tregtise dhe Industrise, Qarku Vlore.

The Project is co-funded by the European Union and by National Funds of Greece & Albania under the IPA Cross-Border PROGRAMME "Greece - Albania 2007-2013"

